




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 31.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **11.08.2020**, të parashtruar nga OE "Bejta Commerce" Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rehabilitimi i rrugës në fshatin Pogradë I=1675 m", me nr të 651-20-4245-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 048 521 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE "Bejta Commerce" Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rehabilitimi i rrugës në fshatin Pogradë I=1675 m", me nr të prokurimit 651-20-4245-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 048 521 e dt. 27.08.2020 kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës 11.08.2020 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës 11.08.2020
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE "Bejta Commerce" Sh.a. ,me datë 27.08.2020 , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Rehabilitimi i rrugës në fshatin Pogradë I=1675 m", me nr të prokurimit 651-20-4245-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 048 521. Autoriteti Kontraktues me datë 31.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 11.08.2020 më saktësisht tek Aneksi nr. 7 kërkohet nga Operatorët Ekonomik që ti përmbahen kësaj të fundit :

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dhe, si dëshmi Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

- 1 (një) Kamion me kran me peshe bartëse 2-3 ton
- 2 (dy) Eskavator me rrota gome me peshe 10-15 ton
- 1 (një) Cilinder me rrota hekur hekur 4-5 ton
- 2 (dy) Grejder min: 12-16 ton
- 1 (një) Kamion me kran me peshe bartëse 2-3 ton
- 1 (një) Korpëngrites > 15m

Me datë 15.08.2020 në ora 9:12 minuta kemi kërkuar sqarim për mjetet e lartcekura dhe kemi erkuar që të largohen kufizimet por nuk kemi marrë përgjigje dhe me datë 26.08.2020 kemi shkuar në zyret e prokurimit dhe na kanë thënë se kërkesa nuk ka arritur të ta fare. Në prezencë të drejtorit të prokurimit dhe zyrtarëve tjerë kemi deklaruar se kërkesën me datën e lartcekur kemi ngarkuar në E-Prokurim dhe e kanë parë edhe vet në faqen tonë të E-Prokurimit dhe nuk kanë ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, se si ka mundësi që kërkesa e jonë të ngarkuar nuk ka arritur të zyra e prokurimit nuk mund ta kuptojmë por ne nuk mundim të bartim pasojat e mosfunksionimit të faqes së E-Prokurimit ose të ndonjë parregullsie tjetër në faqen elektronike të E-Prokurimit. Dokumentin e shkarkuar me datë dhe orë do ja bashkangjeshim si dëshmi kësaj kërkesë. Kërkojmë që këto kufizime të mjeteve që dyshojmë se janë bërë me qëllim pasi i kanë parë mjetet tona dhe i kanë kufizuar kërkesat në mënyrë që të mos mund të marrim pjesë, të largohen dhe të na mundësohet marrja pjesë në tender sepse AK e ka për obligim ligjor që të krijojë kushte që sa më shumë operatorë të marrin pjesë në tender dhe nuk guxon që të vendosë kritere diskriminuese siç e parasheh edhe ligji në nenin 7.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit :

Ne si AK – Autoritet Kontraktues , Komuna Gjilan duke u bazuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë rreth Sqarimit të DT fillimisht ju njoftojmë se afatet ligjore për këtë pike është kaluar.

Rreth parashtrimit të Sqarimit të DT nga ana juaj ku pretendoni se keni ngritur në platformë me datë 15.08.2020 ju njoftojmë se ne si AK nuk kemi pranuar këtë Kërkesë nga ana juaj.

Mirëpo, në mënyrë që të jemi sa më transparent pasi që keni qenë dhe ju present në Zyret e Prokurimit dhe keni parë dhe vet që Kërkesë e tillë nuk na u është adresuar neve dhe për atë arsye nuk ka ekzistuar mundësia që të miret në shqyrtim nga ana jonë. Rrjedhimisht, AK në bazë të LPP-së ka vazhduar procedurat për këto aktivite. Për këtë ju keni mundur që të ju drejtoheni edhe HelpDesk-ut si OE për këtë çështje.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit shpallë pjesërisht të bazuar pretendimet e juaja ankimore.
Rrjedhimisht, bazohuni në Korigjimin e Dosjes Së Tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Izet Kurteshi



U.D Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.